

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**L I G J**  
**Nr.10 103, datë 26.3.2009**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN PËR  
STATUSIN E MISIONEVE DHE TË PËRFAQËSUESVE TË SHTETEVE TË TRETA  
NË ORGANIZATËN E TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT”**

Në mbështetje të neneve 2 pika 3, 83 pika 1, 84 pika 4 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen për statusin e misioneve dhe të përfaqësuesve të shteteve të treta në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut”, bërë në Bruksel më 14 shtator 1994.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R E**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**MARRËVESHJE**  
**MBI STATUSIN E MISIONEVE DHE PËRFAQËSUESVE TË SHTETEVE TË  
TRETA NË ORGANIZATËN E TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT**

Duke pasur parasysh Deklaratën mbi Paqen dhe Bashkëpunimin të bërë nga kryetarët e shteteve dhe qeverive që morën pjesë në takimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut në Romë në datat 7 dhe 8 nëntor 1991 ku bëhej thirrje për ngritjen e një Këshilli për Bashkëpunimin e Atlantikut të Veriut si edhe Deklaratën e Këshillit për Bashkëpunimin e Atlantikut të Veriut mbi Dialogun, Partneritetin dhe Bashkëpunimin të datës 20 dhjetor 1991; duke vërejtur ftesën për Partneritet për Paqe të lëshuar e të nënshkruar nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të Shteteve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut në takimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut të mbajtur në Bruksel më 10 janar 1994; duke njohur nevojën për të përcaktuar statusin e misioneve dhe përfaqësuesve të shteteve të treta në Organizatë;

duke pasur parasysh se qëllimi i privilegjeve dhe imuniteteve që përmbahen në këtë Marrëveshje nuk është që të sjellë përfitime për individët por që të sigurojë kryerjen e

efektshme të funksioneve të tyre në lidhje me Organizatën;  
palët në këtë Marrëveshje kanë rënë dakord si vijon:

### **Neni 1**

Për qëllime të kësaj Marrëveshje:

"Organizata" nënkupton: Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut;

"Shtet anëtar" nënkupton: Një shtet anëtar në Traktatin e Atlantikut të Veriut të arritur në Uashington, më 4 prill 1949;

"Shtet i tretë" nënkupton: Një shtet i cili nuk është palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut të arritur në Uashington, më 4 prill 1949 dhe që ka pranuar ftesën për Partneritet për Paqe e ka nënshkruar Dokumentin Kuadër të Partneritetit për Paqe, është një shtet anëtar i Këshillit për Bashkëpunimin e Atlantikut të Veriut ose është çdo shtet tjetër i ftuar nga Këshilli i Atlantikut të Veriut për të vendosur një mision pranë Organizatës.

### **Neni 2**

a) Shteti anëtar në territorin e të cilit ka selinë Organizata do t'i japë misioneve të shteteve të treta pranë Organizatës dhe anëtarëve të personelit të tyre, privilegjet dhe imunitetet që i janë dhënë misioneve diplomatike dhe personelit të tyre;

b) Për më tepër, shteti anëtar në territorin e të cilit ka selinë Organizata do t'i japë privilegjet dhe imunitetet tradicionale përfaqësuesve të shteteve të treta, me mision të përkohshëm, të cilët nuk mbulohen nga paragrafi (a) i këtij neni, ndërsa janë të pranishëm në territorin e tij, me qëllimin e sigurimit të përfaqësimit të shteteve të treta në lidhje me procedimet e Organizatës.

### **Neni 3**

a) Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare dhe do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit apo miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit apo miratimit do të depozitohen pranë Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës e cila do të njoftojë të gjitha shtetet nënshkruese mbi depozitim të çdo instrumenti të tillë;

b) Sapo dy ose më shumë shtete nënshkruese, duke përfshirë këtu shtetin anëtar në territorin e të cilit Organizata ka selinë e saj, të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit apo miratimit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në lidhje me ato shtete. Ajo do të hyjë në fuqi në lidhje me secilin shtet tjetër nënshkrues në datën e depozitimit të instrumentit të tij.

### **Neni 4**

a) Kjo Marrëveshje mund të denoncohet nga cilido shtet kontraktues duke dhënë një njoftim me shkrim mbi këtë denoncim tek Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës e cila do të njoftojë të gjitha shtetet nënshkruese mbi çdo njoftim të tillë;

b) Denoncimi do të hyjë në fuqi një vit pas marrjes së njoftimit nga Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës.

Në dëshmi të kësaj nënshkruesit, duke qenë të autorizuar siç duhet nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje tekstet e së cilës në anglisht dhe frëngjisht janë njëllorj autentike.

Bërë në Bruksel, më 14 shtator 1994.